

LËNDA: **Kërkesë/Koment** lidhur kërkesën për leje ndërtimore 05 Nr. 350/02-41264/25.

I/e nderuar.

Lidhur me njoftimin publik të Komunës së Prishtinës, për kërkesën me nr. 05 Nr. 350/02-41264/25, datë 24.03.2025, paraqitur nga aplikuesi/investitori “FLUX SH.P.K.”, me seli në Prishtinë dhe NUI 811256503, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e objektit banesor dhe afarist me lartësi 2B+P+13, në kuadër të bllokut urban “F2-3/ZSHP” të tërësisë urbane “F” në Planin Rregullues të Hollësishëm “Kalabria” 2024-2032, konkretisht për parcelat kadastrale nr. 2855-40, 2855-42 dhe 2855-54, ZK Prishtinë.

Ne, [REDACTED] në cilësinë e palës me interes – bashkëpronarë të parcelës fqinje me numër kadastral 02855-43, ju informojmë si më poshtë::

Projekti në fjalë prek rrugën që ndodhet në parcelat 02855-54 dhe 02855-52, e cila përbën të vetmen rrugë të qasjes për pronën tone 02855-4, ku kemi të ndërtuar shtëpinë dhe jetojmë, si dhe për disa parcela të tjera përreth. Çdo ndërhyrje apo devijim i kësaj rruge është i papranueshëm dhe shihet si veprim tendencioz.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, rruga pas realzimit të projektit parashihet të kalojë përmes një hapësire të destinuar si parking privat i objektit banesor/afarist, çka do të pamundësonë aksesin e lirë për parcelat: 02855-43, 02855-2 dhe të tjera parcela fqinje – gjë që mund të vërtetohet edhe përmes analizës së pamjeve satelitore. Si rezultat, cenohet drejtpërdrejt e drejta jonë ligjore e kalimit (servitut).

Gjithashtu, ju njoftojmë se rruga në fjalë është një pronë e kontestueshme, për shkak se secili nga pronarët e parcelave që kanë qasje në të, në momentin e blerjes së pronës, ka paguar edhe për pjesëmarrje në pronësi të kësaj rruge. Prandaj, në rast të cenimit të së drejtës sonë të

[REDACTED]

qasjes, do të jemi të detyruar që përveç ushtrimit të të drejtës së servitutit, të kërkojmë edhe njohjen e së drejtës së pronësisë mbi të dhe si rrjedhoj të kërkojmë ndalimin e këtij projekti përmes rrugës gjyqësore dhe ngarkimin e përgjegjësisë ndaj personave kompetent.

Si përfundim, kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës që:

1. Të refuzojë miratimin e kushteve ndërtimore sipas kërkesës me nr. 05 Nr. 350/02-41264/25, për shkak se projekti parashikon ndërhyrje në rrugën ekzistuese publike që ndodhet në parcelat 02855-54 dhe 02855-52 që shërben si e vetmja rrugë qasjeje për pronën tonë dhe pronat përreth.
2. Të garantojë ruajtjen e rrugës ekzistuese dhe të së drejtës së qasjes për pronarët e parcelave fqinje, si një e drejtë e ligjshme dhe e patjetërsueshme dhe se çdo ndryshim në infrastrukturën rrugore përbën shkelje të së drejtës sonë ligjore.

Prishtinë, datë 20.08.2025

[REDACTED]

AUTORIZIM

Që të përfaqësoj interesat e mia para çdo organi kompetent, Gjykate të rregullt, prokurorisë, organeve policore, administrative dhe përmbarimore, të parashtroj çdo mjet juridik dhe të ndërmarrë çdo veprim juridik për të firmosur dokumente të nevojshme për realizimin e të drejtave të myja në çdo procedurë gjyqësore apo organi tjetër kompetent. Posacërisht përmes këtij autorizimi avokati autorizohet që të zhvilloj procedurën për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe të shërbimi me parcelën fqinje për shfrytëzimin e rrugës.

- 1) Që në emrin tim dhe për llogarinë time të ndërmarrë veprime dhe të më përfaqësoj në procedurat penale, kontestimore, jo kontestimore dhe përmbaruese, të lidhë ujdi gjyqësore apo nëpërmjet ndërmjetësimit, të ushtrojë ose të térheqë padi apo mjete juridike të ngritura, të ushtrojë mjete të jashtëzakonshme juridike dhe të më përfaqësojë në çdo instance gjyqësore apo procedurë administrative apo para organi tjetër kompetent;
- 2) Të ndërmarrë veprime tjera juridike për të cilat cilëson se janë të nevojshme apo të dobishme për procedurat në emër dhe në llogarinë time;
- 3) Të më përfaqësojë dhe të nënshkruaj akte të dobishme ose të nevojshme me qëllim të përfundimit të procedurave në emër dhe për llogari time;
- 4) Të dorëzojë dhe të pranojë shkresa dhe të ndërmarrë veprime që vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme lidhur me çështjen e lartë shënuar në emër dhe llogari time lidhur me kontestet e ngritura;
- 5) Që të pranoj mjetet e kompensimit për të dëmtuarin në llogarinë e tij bankare të cilat pastaj përmes llogarisë së avokatit do ti barten të përfaqësuarit.
- 6) Që autorizimin e dhënë ta bartë në personin e tretë në kufijtë e këtij autorizimi.

Autorizimdhënësi ka për detyrë që në thirrjen e të autorizuarit të paguaj taksat gjyqësore dhe shpenzimet e tjera kur ato paraqiten apo ndonjë obligim tjetër në përputhje me kontratën përofrimin e shërbimeve juridike të lidhur me avokatin. I autorizuari nuk mban përgjegjësi nëse informacionet nuk janë dhënë të sakta ose nuk janë ofruar fare. Autorizimdhënësi do të përkushtohet të mbrojë dinjitetin duke iu përbajtur parimit të mirëbesimit, ndërgjegjshmërisë dhe nderit si në aspektin material ashtu edhe atë moral.

Prishtinë, 16/08/2025

AUTORIZIM

Që të përfaqësoj interesat e mia para çdo organi kompetent, Gjykate të rregullt, prokurorisë, organeve policore, administrative dhe përbartimore, të parashtoj çdo mjet juridik dhe të ndërmarrë çdo veprim juridik për të firmosur dokumente të nevojshme për realizimin e të drejtave të myja në çdo procedurë gjyqësore apo organi tjetër kompetent. Posacërisht përmes këtij autorizimi avokati autorizohet që të zhvilloj procedurën për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe të shërbimi me parcelën fqinje për shfrytëzimin e rrugës.

- 1) Që në emrin tim dhe për llogarinë time të ndërmarrë veprime dhe të më përfaqësoj në procedurat penale, kontestimore, jo kontestimore dhe përbartuese, të lidhë ujdi gjyqësore apo nëpërmjet ndërmjetësimit, të ushtrojë ose të térheqë padi apo mjete juridike të ngritura, të ushtrojë mjete të jashtëzakonshme juridike dhe të më përfaqësojë në çdo instancë gjyqësore apo procedurë administrative apo para organi tjetër kompetent;
- 2) Të ndërmarrë veprime tjera juridike për të cilat cilëson se janë të nevojshme apo të dobishme për procedurat në emër dhe në llogarinë time;
- 3) Të më përfaqësojë dhe të nënshkruaj akte të dobishme ose të nevojshme me qëllim të përfundimit të procedurave në emër dhe për llogari time;
- 4) Të dorëzojë dhe të pranojë shkresa dhe të ndërmarrë veprime që vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme lidhur me çështjen e lartë shënuar në emër dhe llogari time lidhur me kontestet e ngritura;
- 5) Që të pranoj mjetet e kompensimit për të dëmtuarin në llogarinë e tij bankare të cilat pastaj përmes llogarisë së avokatit do ti barten të përfaqësuarit.
- 6) Që autorizimin e dhënë ta bartë në personin e tretë në kufijtë e këtij autorizimi.

Autorizimdhënësja ka për detyrë që në thirrjen e të autorizuarit të paguaj taksat gjyqësore dhe shpenzimet e tjera kur ato paraqiten apo ndonjë obligim tjetër në përpunhje me kontratën përofrimin e shërbimeve juridike të lidhur me avokatin. I autorizuari nuk mban përgjegjësi nëse informacionet nuk janë dhënë të sakta ose nuk janë ofruar fare. Autorizimdhënësja do të përkushtohet të mbrojë dinjitetin duke iu përbajtur parimit të mirëbesimit, ndërgjegjshmërisë dhe nderit si në aspektin material ashtu edhe atë moral.

Prishtinë, 16/08/2025